



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Durrës 08.04.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

Gjatësia totale e rrjetit rrugor urban brenda qytetit nën administrimin e Bashkisë Durrës:

- 177.07 km gjatësi lineare

Ndahet në dy kategori:

- Kryesore - 78.02 km linear gjatësi
- Dytësore (sekondare – të brendëshme) – 99.05 km linear gjatësi

Përgjithsisht gjendja e rrugëve është e mire, duke patur parasysh amortizimin e vazhdueshëm të tyre prej trafikut të rënduar, erozionit prej rreshjeve dhe përmbytjeve të shpeshta, dëmtimeve që vijnë prej subjekteve të treta gjatë çarjeve që u bëjnë rrugëve për kalim të linjave të tubacioneve dhe kalimin e rrjetetve kabllore/internet.

Për sa më lart kryhet dhe mirëmbajtje nga Ndërmarrja Rruga periodikisht për çdo vit në për eliminimin e defekteve që paraqiten.

Lista rrugëve planifikuar nga Ndërmarrja Rruga për vitin 2026 që:

- **kërkojnë ndërhyrje për rehabilitim dhe mirëmbajtje prioritare sipas tabelës:**

□

Rrugë që parashikohet të ndërhyet në vitin 2026		
Nr	Problematika	Kml/m ²
1	Gropëzime, Amortizim shtrese asfalti	35.6 Km
2	Sistemim, shtrim, asfaltim	2.32 Km

- **Me problematika emergjente si më poshtë:**

□

1	Sistemim, shtrim dhe asfaltim	0.8 km
2	Gropëzime, Amortizim shtrese asfalti	2 km

Investimet që Bashkia Durrës ka realizuar nëpërmjet Ndërmarrjes Rruga, për ndërhyrjet në rrugët urbane gjatë viteve 2021-2025 me vlerat sipas viteve janë si më poshtë:

□

Viti i investimit	2021	2022	2023	2024	2025
Vlera e investimit	94,498,800 lekë	111,291,786 lekë	111,189,547 lekë	67,004,176 lekë	71,117,996 lekë

Bashkia Durrës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ka vijuar ndër vite angazhimin për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në territorin e saj

Gjatë periudhës 2021–2025, investimet në infrastrukturën rrugore janë realizuar përmes një zëri të dedikuar në buxhetin e Bashkisë Durrës, ku për çdo njësi administrative është parashikuar fondi prej 20,000,000 lekësh në vit, si dhe janë ndërmarrë ndërhyrje të një natyre të ngjashme edhe në rrugët brenda territorit urban të qytetit. Paralelisht, Bashkia Durrës ka aplikuar pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit për sigurimin e financimeve shtesë me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës rrugore, si në njësitë administrative, ashtu edhe në qytet.

Për vitin aktual, planifikimi buxhetor parashikon ndërhyrje të fokusuara në rikonstruksionin e rrugëve të amortizuara dhe të dëmtuara, të cilat nuk kanë qenë objekt investimi në periudhat e mëparshme, kryesisht në njësitë administrative të Bashkisë Durrës. Këto ndërhyrje synojnë përmirësimin e qarkullimit të automjeteve, rritjen e sigurisë në lëvizje dhe garantimin e qëndrueshmërisë së infrastrukturës rrugore në një horizont afatgjatë.

Ndërhyrjet teknike do të realizohen në varësi të gjendjes fizike dhe parametrave teknikë të rrugëve ekzistuese. Në rastet kur dëmtimet e shtresës asfaltike janë të theksuara, por me çedime mesatare, parashikohet ndërhyrje përmes skarifikimit të shtresave ekzistuese dhe rindërtimit të tyre me shtresa çakëlli, stabilizanti, binderi dhe asfaltobetoni, sipas standardeve përkatëse. Ndërsa në rastet kur dëmtimet dhe deformimet e trupit të rrugës janë të konsiderueshme,

ndërhyrja konsiston në një proces më të thelluar rikonstruksioni, me shtresa të shtuara për të garantuar qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi më të madhe të segmentit rrugor.

Projektet e rikonstruksionit në zonat urbane kanë si synim jo vetëm përballimin e rritjes së kërkesës për qarkullim, por edhe harmonizimin funksional dhe estetik të infrastrukturës rrugore me zhvillimin e përgjithshëm të qytetit. Këto ndërhyrje fokusohen në zona që kanë pësuar zhvillim të dukshëm në vitet e fundit dhe që parashikohet të vijojnë me të njëjtin ritëm, duke e bërë të domosdoshëm përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës për t'iu përgjigjur kësaj dinamike.

Duke vlerësuar rëndësinë e këtij procesi, Bashkia Durrës mbetet e angazhuar për të garantuar standarde të larta në planifikimin dhe zbatimin e investimeve në infrastrukturën rrugore, në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.